



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.68/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziç dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtaren e lartë ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR dega në Malishevë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, kështu që koalicionit LDK-AKR dega në Malishevë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1800 (*njëmijë e tetëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 05.06.2017, nga, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datë 05.06.2017, rreth orës 12:00, në qendër përkatësisht në rrugën “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu” në Malishevë aktivistja Antigona Kryeziu ka vërejtur se në kabinën telefonike në afërsi të postës ishte vendosur postieri i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Salih Morina nga radhët e koalicionit LDK-AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së nr.11/2013, vendosja e materialit zgjedhor brenda apo jashtë ndërtesave publike ose godinave përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre. Parashtruesi i ankesës konsideron se nga këto veprime koalicioni LDK-AKR ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 dhe nenit 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014 i KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni LDK-AKR, thekson se lidhur me pretendimet e Institutit Demokratik të Kosovës dhe urdhëresës së PZAP-it për të ndërmarrë masa përmisuese, kanë informuar se kandidatët për deputet nga subjekti i tyre politik i kanë larguar posterat në fjalë.

Në cilësinë e provës, përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur foton që e dëshmojnë gjendjen e tanishme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit i kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Salih Morina nga radhët e koalicionit LDK-AKR dega në Malishevë është vendosur në kabinën telefonike pra në afërsi të postës në hapsirë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posterit i kandidatit për deputet nga ky subjekt politik është vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicioni në fjalë, ia dha mundësin për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje e pranuar nga ana e tyre shihet qarte se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprimet për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar i cili veprim ka ndikuar në lartasin e gjobës së shqiptuar si në diapozitiv te këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.68/2017 më datën 06.06.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.